

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Seanca nr.2004/09

Prishtinë, më 27 maj 2004, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Bajram **Kosumi**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 79 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryesia ia kishte propozuar Kuvendit këtë

REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit të sesionit të mëparshëm;
2. Shqyrtimi i raportit të Grupit të Punës për amendamentimin e Kornizës Kushtetuese;
3. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për ndërtimet, nr.2004/13;
4. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për ndërmarrjet, nr.2004/4;
5. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për veprimtaritë hoteliere dhe turistike, nr.2004/3;
6. Amendamenti i Ligjit për produktet dhe pajisjet medicinale, 2003/26;
7. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, nr.2004/16;
8. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për tregtinë e brendshme, 2004/18;
9. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për koncesione, nr.2004/19;
10. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për gatishmërinë emergjente civile, nr.2004/15;
11. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për veterinarinë, nr.2004/14;
12. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për tatimin në të ardhurat personale, 2004/17;
13. Shqyrtimi i raportit përfundimtar të buxhetit të Kosovës për vitin 2003 dhe
14. Shqyrtimi i raportit të buxhetit për tre mujorin e parë të vitit 2004.

Kryetari propozoi që pikat 6, 13 dhe 14 të hiqen nga rendi i ditës – ngase nuk ishin bërë përgatitjet e nevojshme për shqyrtimin e tyre.

Haki Shatri tha se kërkesa e Komisionit për Buxhet ka qenë që në seancën e sotme të shqyrtohet raporti përfundimtar i Buxhetit të Kosovës për vitin 2003, ngase në bazë të dispozitave të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe të përgjegjësive, ai duhet të shqyrtohet menjëherë porsa të ketë kaluar marsi, gjegjësisht gjatë muajit prill.

Ministri Ali Sadriu tha se në Ligjin për menaxhimin e financave publike parashihet që raporti përfundimtar i buxhetit dërgohet përmes librit të buxhetit dhe koha e raportimit të tij është deri më 30 qershor, kurse më 30 mars mbyllet librat. Periudha nga 31 mars deri 31 qershor është periudhë e përgatitjes së të gjitha atyre transaksioneve.

Berat Luzha tha se kthimi i martirëve shqiptar, të kidnapuar, të ekzekutuar dhe pastaj të hudhur nëpër varreza masive në Serbi, në grupe të ndara, po shkakton pezmadhe dhe revoltë të arsyeshme në opinionin tonë dhe veçanërisht te familjarët dhe te shoqarat e tyre. Shoqatat e familjarëve janë në shqyrtim të vendimit që të mos i marrin nga murgu i Rahovecit kufomat e martirëve - si reagim dhe protestë për shkak të kthimit të tyre në grupe, si dhe për shkak të pakënaqësisë së tyre me punën e institucioneve vendore me këtë.

Ai propozoi të radhitet në rendin e ditës të seancës së sotme, si çështje e ngutshme – kthimi i menjëhershëm dhe i të gjitha kufomave të martirëve shqiptar, që janë në varrezat masive në Serbi.

Kryetari tha se i përkrah shqetësimet që ingriti deputeti Berat Luzha, por për ta radhitur këtë çështje në rend dite të seancës plenare, paraprakisht duhet që Komisioni përkatës i Kuvendit dhe ai i Qeverisë ta shqyrtojnë këtë çështje dhe t'ia propozojnë Kuvendit qëndrimet dhe rekomandimet për shqyrtim dhe miratim.

Me kërkesën e kryetarit u hoqën nga rendi i ditës pikat e 6, 13 dhe 14, të propozuara nga Kryesia për këtë seancë.

1. Miratimi i procesverbalit të sesionit të mëparshëm

Procesverbali i sesionit të mëparshëm u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i raportit të Grupit të punës për amendamentimin e Kornizës Kushtetuese

Kryetari e ftoi Arsim Bajramin ta arsyetonte raportin e Grupit të Punës për amendamentimin e Kornizës Kushtetuese.